



DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

THIRRJE PUBLIKE

13.02.2023

Shkruar

Duke u bazuar në “Rregullore MF – NR – 04/2017 të datës 21.06.2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve” Komuna e Klinës – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

10-451-4824/23

Thirrje publike – për mbështetje financiare për vitin 2023, për OJQ - Shoqatat e Dalura nga Lufta që veprojnë në komunën e Klinës, programi i të cilave është i fokusuar në fushëveprimtarinë e shënimit të datave historike, përvjetorë, homazhe, akademi përkujtimore etj.

Data e hapjes së thirrjes 13.02.2023

Afati i fundit për aplikim 03.03.2023

- Shoqatat në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte/programe të tyre në organizime përkatëse:
 - Organizimi i datave me rëndësi historike, përvjetorë, akademi përkujtimore, homazhe etj.
 - Organizimi i aktiviteteve sipas fushëveprimtarisë që organizatat e kanë në statusin e regjistrimit në ministrinë përkatëse.
- **Mënyra si të aplikoni, dokumentet e nevojshme:**
 - Formulari i aplikimit - Forma e projektit (aktiviteteve)
 - Dokumenti identifikues (kopje)
 - Certifikatë që dëshmon për regjistrimin e OJQ-së në Ministrinë e Administratës (kopje)
 - Certifikatë e numrit fiskal (kopje) – të jetë me seli në Klinë, nëndegën në Klinë
 - Konfirmim nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit
- **Formularët për aplikim i gjeni në web-faqen e Komunës së Klinës.**

- Afati i aplikimit është 15 ditë pune nga dita e shpalljes, duke filluar nga data 13.02.2022 deri më 03.03.2022
- Aplikacionet e plotësuara duhet të dorëzohen personalisht nga aplikuesi, të jenë të vendosura në zarf dhe të protokolohen në arkivin komunal.

Vërejtje:

1. Aplikacionet që dorëzohen pas afatit të paraparë nuk pranohen.
2. Të gjithë aplikuesit që nuk e kanë të kompletuar dokumentacionin e kërkuar, nuk do të vlerësohen dhe nuk do të merren parasysh.

Klinë, 13.02.2023

Drejtoreshë për kulturë, rini dhe sport;

Fatjona GASHI

